



International  
Federation  
of Accountants®

## Edukimi Kontabël IFAC – Instrumenti Elektronik dhe Udhëzuesi për Sektorin Publik 21 prill 2021

### Prezantues:

Helen Partridge

Drejtoreshë, Edukimi Kontabël

Rania Uwaydah

Anëtare, IPAE, ish-anëtare e BSNEK-  
së, & Kryetare e Taskforcës PSTF

# Programi

- Qasja e re për edukimin kontabël nga IFAC
- Standardet Ndërkombëtare të Edukimit që kanë hyrë në fuqi së fundmi
- Nismat për edukimin kontabël
- Demonstrim i eTool (video)
- Udhëzuesi për zbatimin në sektorin publik

# Qasja e re për edukimin kontabël nga IFAC


Click on image to watch video



- Qasje e gjithanshme e integruar për çuarjen përpara të EK-së
- Mandat i gjerë, funksion ndërtematik, shfrytëzim i avantazheve konkurruese
- Kornizë angazhimi me disa palë interesi
  - Forumi ndërkombëtar i palëve kryesore të interesit për EK-në
  - Forumi ndërkombëtar i drejtorëve për EK-në
  - Paneli ndërkombëtar për edukimin kontabël
    - Këshillim, konsultim, punë bindëse


# Rishikime të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit që kanë hyrë në fuqi së fundmi

- SNE 2 – Zhvillimi profesional fillestar – kompetenca teknike
- NSE 3 – Zhvillimi profesional fillestar – aftësitë profesionale
- SNE 4 – Zhvillimi profesional fillestar – vlerat, etika dhe qëndrimet profesionale
- SNE 8 – Kompetenca profesionale për partnerët e angazhimit përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare




# Situatat e tregut të punës 2025

## 10 profesionet e reja më në ngritje



Analist dhe shkencëtar i të dhënave  
Specialist i IA-së dhe i të mësuarit kompjuterik  
Specialist në të dhënat e mëdha  
Specialist në marketing dhe strategji digjitale  
Specialist i automatizimit të proceseve  
Profesionist i zhvillimit të biznesit  
Specialist i transformimit digjital  
Analist i sigurisë informatike  
Zhvillues softueri dhe aplikacioni  
Specialist i internetit të sendeve


## 10 profesionet më në rënie



Nëpunës i shkrimit të të dhënave  
Sekretar administrativ dhe ekzekutiv  
Nëpunës kontabël, llogaritar dhe mbajtjen e borderove  
Kontabilist dhe auditues  
Punëtor montimi dhe fabrike  
Menaxher i shërbimeve të biznesit dhe administratës  
Punonjës i informimit të klientëve dhe shërbimit të klientëve  
Menaxher i përgjithshëm dhe i operacioneve  
Mekanik dhe riparues makinerish  
Nëpunës inventari dhe magazine

Burimi: Future Job Report 2020  
Forumi Ekonomik Botëror

# Çfarë drejtimi ka marrë profesioni?



#ClimateWeekNYC



**"The accounting profession  
is absolutely essential."**

**Mark Carney**

**COP 26 Finance Adviser and UN Special Envoy**



## IFAC Accountancy Education E-Tool

Video Demonstration  
June 2020





# Udhëzuesi për sektorin publik

---

*Prezanton:*

***Rania Uwaydah, Anëtare, IPAE, ish-anëtare e BSNEK-së, & Kryetare e Taskforcës PSTF***

# (Ish-)Projekti për sektorin publik i BSNEK-së

- Taskforca **krijohet** në prill 2017; puna fillon në qershor 2017
- **Analiza e mjedisit**
  - Një nxitje e fortë për t'u kërkuar llogari qeverive → sistemet e qeverisjes së sektorit publik → MFP, transparencë dhe integritet
  - Pritje më të mëdha nga profesioni kontabël në SP: standarde cilësore, futje në përdorim dhe zbatim efektiv kur:
    - Mjedisi MFP është gjithnjë e më kompleks
    - Përvoja e kontabilitetit në SP është e kufizuar
    - Njohuritë kontabël të atyre që i përdorin standardet janë të kufizuara
- **Çështja**, atëherë, është: *A i përgatitin SNE-të kontabilistët tanë për këtë rol të vështirë i cili është në evoluim?*

# Taskforca për Sektorin Publik: Faza 1

## METODIKA

- Shqyrtimi i literaturës dhe puna afruese me palët e interesit

## KONSTATIMET

- SNE-të tona perceptohen se orientohen drejt sektorit privat
- Gjërat që u kërkohet të bëjnë kontabilistët e sektorit privat dhe ata të sektori publik dallojnë në themel
- Pra, perceptohet një nevojë për ta zgjeruar ofertën e arsimimit për sektorin publik

**REZULTATI:** Identifikimi dhe miratimi i projektit (nëntor 2017)

# Projekti për Sektorin Publik

## QËLLIMI

Identifikimi i aftësive dhe kompetencave që u nevojiten kontabilistëve profesionistë për përmbushjen e roleve të tyre në kontabilitetin, raportimin financiar dhe sigurinë në sektorin publik, për t'u trajtuar nga SNE-të.

## OBJEKTI

1. Kryerja e një analize të thellë
2. Identifikimi i karakteristikave dalluese të profesionit kontabël në SP
3. Kryerja e analizës së hendekut midis këtyre dhe SNE-ve ekzistuese
4. Të kuptuarit e efektit mbi nevojat për mësim dhe zhvillim.

- **Identifikimi i literaturës përkatëse:** kornizat e kompetencës, programet e lëndëve për SP-në dhe aftësitë e degëve të qeverisjes
- **Shqyrtim në nivel global**
- **Shqyrtim i hollësishëm i 7 dokumenteve të përzgjedhura**
- **Identifikimi i boshllëqeve dhe i vendit që zënë në fushat e kompetencës së SNE-ve**
- **Përcaktimi i boshllëqeve të përmendura më shpesh**

# Përmbledhje e konstatimeve

- ✓ **TRI KATEGORI TË GJERA**
  - praktikat e raportimit financiar dhe të menaxhimit financiar
  - praktikat e auditimit dhe të sigurisë dhe
  - mjedisi politik dhe i politikave publike
- ✓ **PËRQENDRUAR NË SNE 2. (ZHPF – KOMPETENCA TEKNIKE)**
- ✓ **TRE LLOJE**

# Përmbledhje e konstatimeve (2)

- Dallime lidhur me **perspektivën / mungesë e lidhjes me SP-në**.
  - Për shembull:
    - Kuadri rregullator:
      - SNE.2(g): “Aktet ligjore e nënligjore **tregtare**”
    - Standardet e raportimit:
      - SNE.2(a): “SNRF-të dhe standardet e tjera përkatëse”, por jo SNKSP-të
- Boshllëqe materiale për shkak të **kërkesave për kompetencat dhe dijet** e lidhura me këto të cilat janë specifike për sektorin.
  - Për shembull:
    - Mjedisi organizativ:
      - SNE 2(1) “roli i shumëkombësheve” dhe “tregtia elektronike”
      - Fushat e dijeve specifike për SP: *natyra dhe gama e “ofrimit të shërbimeve publike”, “vendosjes së politikave publike” dhe “partneriteteve publike-private”*
    - Shkenca ekonomike:
      - SNE 2(j) “llojet e strukturave të tregut, përfshirë konkurrencën e përsosur, konkurrencën monopoliste, monopolin dhe oligopolin”
      - Fushat e dijeve specifike për SP: *“borxhi publik dhe ndikimi që mund të ketë në nivelet e veprimtarisë ekonomike, rregullimin ekonomik dhe qeverisjes fiskale”*
- Dallimet që u përkasin fushave shumë të specializuara, të tilla si auditimi i përputhshmërisë dhe i performancës
  - Për shembull:
    - *Auditimet e përputhshmërisë, auditimet e marrjes së maksimumit të vlerës së parasë* janë të rëndësishme për SP-në, mirëpo vetëm auditimi i pasqyrave financiare përmendet në SNE2 dhe SNE8

# Material mbështetës për zbatimin

- Rezultate mësimore ilustruese për kurikulën kontabël të sektorit publik
- Shembull ilustrues: Projektimi i rezultateve mësimore për kurikula që përputhen me profesionin kontabël të sektorit publik